

ALBKROM sh.a.

Shenime per pasqyrat financiare për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2020
(Te gjitha shumat jane ne LEK, nese nuk shprehet ndryshe)

IV. Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare

A. Informacion i Përgjithshëm

Shoqëria është krijuar juridikisht, datë 18.01.1996. Referuar Vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr.14014/5, datë 24.03.2004 dhe Urdhërit Nr.38 datë 01.03.2004 të Ministrit të Ekonomisë Shoqëria kalon nga Albkrom sha. Tiranë në "Albkrom" sh.a. (në likuidim e sipër) Tiranë.

Kapitali i nënshkruar i saj është në vlerën 3.405.413.240 lekë.

Likuidator është z. Flamur Qeli.

- Objekt i veprimtarisë së shoqërisë është shitjen e asetëve të shoqërisë
- Gjatë periudhës nga 01.01.2020 deri më 31.12.2020 shoqëria ka kryer aktivitetin e saj në përputhje me objektin e saj.

Kapitali i nënshkruar i saj është 3.405.413.240, dhe numri i aksioneve është 3.405.413,00 me vlerë nominale 1,000 lekë

Numri i punonjesve: 19, për vitin 2020

NIPT: J61827513H

B. Përmbledhje e Politikave Kryesore Kontabël

1. Mënyra e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare

Këto pasqyra financiare janë përgatitur me parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, sipas kostos historike, me përjashtim të rasteve që përcaktohen ndryshe në se ka të tilla.

Monedha funksionale është LEK-u shqiptar ("LEK"), valuta e huaj USD është konvertuar në Lekë.

Bazat e Ndërtimit të Pasqyrave Financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-ve), përbëhen nga pozicionet financiare, të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra e fluksit të parasë dhe pasqyra e ndryshimeve në kapital si dhe shënimet shpjeguese.

Perdorimi i gjykimeve

Paraqitja e Pasqyrave Financiare në përputhje me SKK, kërkon që menaxhimi të bëjë vlerësime dhe gjykime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe vlerën e raportuar të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave e shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht. Rishikimet dhe vlerësimet kontabël njihen në periudhën kur ndodh rishikimi dhe në çdo periudhë të ardhshme që i përket.

Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të shoqërisë janë përgatitur mbi supozimin e biznesit i cili është në proces likuidimi.

Krahasueshmëria

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas sistemit kontabël Shqiptar. Të dhënat krahasuese pasqyrojnë gjendjen e pozicionit financiar të shoqërisë në 31 dhjetor 2020 kundrejt vitit 2019.

2. Transaksionet në Monedha të Huaja

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilin është kryer transaksioni. Aktivitetet dhe pasivitetet monetare në monedhë të huaj në datën e mbylljes së bilancit janë rivlerësuar në monedhën funksionale sipas kursit të shpallur nga Banka e

ALBKROM sh.a.

Shenime per pasqyrat financiare për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2020

(Te gjitha shumat jane ne LEK, nese nuk shprehet ndryshe)

Shqipërisë në datën e mbylljes së periudhës ushtrimore. Diferencat që rrjedhin si rezultat i rikontimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të përdorura në konvertimin e gjendjeve të bilancit emertuar në monedhë të huaj në datën e hartimit të bilancit janë si më poshtë (në LEK):

	<u>31.12.2020</u>	<u>31.12.2019</u>
Kurse e këmbimit		
USD/ Leke	100.84	108.64

3. Instrumentat Financiare

Instrumentat financiarë të shoqërisë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, likuiditete dhe vlera arke të tjera, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

Njohja Fillestare

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit në fjalë. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin.

Instrumentat financiarë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç rasteve nëse përcaktohet ndryshe. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura.

Njohja e Metejshme

Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë maten siç përshkruhet më poshtë.

Paraja dhe Ekuivalentet

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parasë, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë depozita pa afat dhe ato me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data fillestare. Likuiditetet dhe vlera arke të tjera maten me tej me fitim/ humbjet nga zhvlerësimet.

Llogari të Arkëtueshme dhe të tjera të arketueshme

Llogaritë e arketueshme tregëtare dhe të tjera nuk mbartin interes dhe paraqiten me vlerë nominale të pakësuar nga zbritjet e nevojshme për shuma që janë vlerësuar të pambledhshme. Vlerësimi i shumave të pambledhshme bazohet në gjykimin e drejtimit.

Llogari të Pagueshme

Llogaritë e pagueshme maten fillimisht me vlerën e tyre të drejtë (domethënë me kosto) dhe më pas me kosto të amortizuar.

Huatë të Dhëna dhe të Marra

Huatë e dhëna: Huatë e arkëtueshme janë aktive financiare jo-derivative me pagesa të përcaktuara ose fikse dhe që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv. Pas matjes fillestare, të tilla aktive financiare maten në vazhdim me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv dhe duke zbritur rënien e vlerës.

Huatë e marra: Huatë (detyrime financiare), janë njohur fillimisht me vlerën e tregut neto nga kostot e transaksioneve dhe me pas njihen me vlerën e amortizuar.

Netimi i Instrumentave Financiare

Aktivitet dhe pasivet financiare netohen dhe shuma neto e tyre raportohet në bilanc nëse, dhe vetëm nëse ka një të drejtë të detyrueshme ligjore për të netuar shumën e njohur dhe ekziston mundësia për të shlyer në shumën neto, apo për të realizuar aktivin dhe shlyer pasivet njëkohësisht.

Zhvlerësime të Aktiveve Financiare

Një aktiv financiar konsiderohet si i zhvlerësuar në ato raste kur ekzistojnë kushte objektive që tregojnë se një apo më shumë ngjarje (pas njohjes së tij fillestare) kanë efekte negative në flukset e ardhshme të parasë që parashikohet të burojnë prej atij aktivi. Vështirësitë e konsiderueshme financiare të debitorit, propabiliteti që debitori do të falimentojë apo një riorganizim financiar, dhe pamundësia apo shkeljet në pagesa konsiderohen si tregues që një llogari e arkëtueshme është e zhvlerësuar.



Ç'rregjistrimi

Aktivitetet financiare së bashku me fondin rezervë të zhvlerësimit çrregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Detyrimet financiare çrregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë përfundojnë, skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Transaksionet me palët e lidhura

Palët të lidhura janë ato, kur njëra prej palëve kontrollohet nga pala tjetër ose ka influencë të rëndësishme në vendimmarrjen financiare ose të biznesit të palës tjetër.

4. Provigjionet

Provigjionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose të tërthortë) si rezultat i një ngjarjeje të shkuar për të cilën ka mundësi që të krijohet një rrjedhë burimesh të nevojshme për të përmbushur detyrimin dhe kur një përlllogaritje e besueshme e shumës së detyrimit mund të llogaritet. Provigjionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më mundësi për nevojën e një rrjedhë burimesh që përfshin përfitime ekonomike për shlyerjen e detyrimit, provigjionet rimerren. Provigjionet përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë njohur fillimisht.

Pasivitetet dhe aktivitetet e kushtëzuara nuk njihen, por vetëm paraqiten në shënimet e pasqyrave financiare të ndërmjetme kur janë materiale.

5. Qiratë

Qirate klasifikohen si qira financiare dhe si qira operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të vogël midis vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të pagesave minimale të qirasë në datën e matjes. Kosto financiare paraqet diferencën midis detyrimit total të qirasë dhe vlerës së drejtë të aktivitetit. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave & shpenzimeve gjatë kohëzgjatjes së qirasë me norma interesi të aplikueshme mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

6. Inventarët

Inventarët regjistrohen në konatibilitet me koston e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për sjelljen e inventarit në vendin e përcaktuar. Për përcaktimin e koston të inventarëve është zgjedhur metoda e koston mesatare.

7. Aktivitetet Afatgjate Materiale (AAM-t)

Njohja dhe Matja : Vlerësimi fillestar i një elementi të AAM-ve që plotëson kriteret për njohje si aktiv në bilanc është vlerësuar me koston e marrjes ose të prodhimit të tyre. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për sjelljen e aktiveve në vendin dhe kushtet ekzistuese.

Njohja Mëpasshme: AAM-të paraqitet me koston minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Nëse një pjesë e një elementi të AAM-së zëvendësohet, kostoja e pjesës së re i shtohet koston të elementit, nëse ajo përmbush kriteret e përkufizimit të AAM-së dhe kriteret e njohjes së aktiveve në bilanc. Pjesa e zëvendësuar do të hiqet nga bilanci edhe nëse ajo nuk është kontabilizuar si pjesë më vete. Nëse kostoja fillestare (rrjedhimisht, edhe vlera kontabël aktuale) e pjesës së zëvendësuar nuk dihet ajo mund të vlerësohet në bazë të koston aktuale të kësaj pjese minus amortizimin e vlerësuar.

Amortizimi: për vitin ushtrimor 2020 shoqëria ka përlllogaritur amortizim për AAM-t vetëm për asetet në inventarin ekonomik në Administratë të blera nga viti 2014 e në vazhdim në vlerën 25.263 leke .

Tokat nuk amortizohen,

Ç'rregjistrimi: Një zë i aktiveve afatgjate materiale çrregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk pritet me përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjate materiale

ALBKROM sh.a.

Shenime per pasqyrat financiare për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2020

(Te gjitha shumat jane ne LEK, nese nuk shprehet ndryshe)

përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të ushtrimit

Zhvlerësimi (Rënia në vlerë): Shoqëria nuk vlerëson në datën e raportimit nëse ka premisa që një aktiv të zhvlerësohet.

8. Aktivet Afatgjata Jo-materiale (AAJM-t)

Aktivët afatgjatë jo-materiale përfshijnë liçensat, të drejtat për përdorim dhe emri i mirë.

Njohja dhe Matja: Liçensat, të drejtat e përdorimit të cilat përftohen nga shoqëria paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

Shpenzimet e Mëpasshme: Shpenzimet pasuese kapitalizohen vetëm në rastin kur shtojnë përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në aktivin specifik me të cilat ato lidhen. Të gjitha shpenzimet njihen si fitim apo humbje në momentin kur kryhen.

Amortizimi: për vitin ushtrimor 2020 shoqëria ka perlllogaritur amortizim vetëm për asetet e blera (pajisje informatike) pas vitit 2014, Për asetet e tjera nuk ka perlllogaritur amortizim

Zhvlerësimi (Rënia në vlerë): Shoqëria nuk vlerëson në datën e raportimit nëse ka premisa që një aktiv të zhvlerësohet.

9. Të Ardhurat & Shpenzimet

Të Ardhurat

Të ardhurat janë krijuar nga Qerata e aseteve në vlerën 1.378.917 leke; 11.560.000 leke fonde miratuar nga MIE për konservim (suvensione nga buxheti), të tjera 4000 leke. Të ardhurat njihen në masën që është e mundur që përfitimet ekonomike do të hyjnë në Shoqëri dhe që të ardhurat mund të maten në mënyrë të besueshme, pavarësisht se kur bëhet pagesa. Të ardhurat maten me vlerë të drejtë të mallit/shërbimit të shitur neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe zbritje të mundshme të shitjeve.

Shpenzimet

Shoqëria njeh shpenzimet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në proporcion me kryerjen e tyre në datën e raportimit. Shpenzimet paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas natyrës së tyre, çka kërkon gjykim të konsiderueshëm nga drejtimi i Shoqërisë.

Të Ardhurat dhe shpenzimet Financiare

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur akumulohen, duke marrë parasysh metodën e interesit efektiv.

Tatimi mbi Fitimin

Tatim fitimi apo humbjet e vitit përbëhet nga tatimi aktual. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si edhe çfardolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

10. Kapitali i Vet

Kapitali i nënshkruar përfaqëson kontributin e aksionerit të vetëm të shoqërisë që është Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë Tiranë.

Kapitali i nënshkruar i saj është 3.405.413.244, dhe numri i aksioneve është 3.405.413,00 me vlerë nominale 1,000 lekë. Kapitali aksioner njihet me vlerën nominale.

11. Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore

Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore që sigurojnë pension për punonjësit. Qeveria shqiptare është përgjegjëse për caktimin e minimumit të kontributit për sigurimet shoqërore në Shqipëri sipas një plani pensioni bazuar në kontribute. Kontributet e shoqërisë në planin e pensionit janë pasqyruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.



ALBKROM sh.a.

Shenime per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2020

(Te gjitha shumat jane ne LEK, nese nuk shprehet ndryshe)

12. Ngjarje pas mbylljes së Pasqyrave Financiare

Ngjarjet pas datës së bilancit që permbajnë informacion shtesë të Shoqërisë, në datën e Bilancit Kontabël (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në Pasqyrat Financiare. Ngjarjet pas bilancit që nuk janë ngjarje rregulluese paraqiten të shpalosura në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare kur janë materiale.

13. Mjetet Monetare

Gjendja e mjeteve monetare në 31.12.2020 dhe më 31.12.2019 është përkatësisht si më poshtë:

Llogarite Bankare Sipas bankave	Monedha	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
		Vlera ne leke	Vlera ne leke
BANKA CREDINS	Leke	33,459	7,096
Totali		33,459	7,096

Veprimet e lëvizjeve monetare në librat e bankës, janë veprime të autorizuar, mbështeten në dokumenta që justifikojnë pagesat dhe arkëtimet, regjistrimet janë kronologjike. Për gjendjen në valutë është bërë rivlerësimi me kursin fiks të bankës Shqipërisë në datën 31.12.2020 dhe diferencat janë pasqyruar në rezultatin e shoqërisë.

14. Të drejta të Arkëtueshme Afatshkurtër

Të drejta të arkëtueshme	Monedha	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
		Vlera ne leke	Vlera ne leke
Nga aktiviteti i shfrytëzimit	Leke	54,211,895	52,483,425
Kreditore te ndryshem	Leke	33,314,792	33,620,733
TVSH per Rimbursim	Leke	66,846,509	68,762,198
Totali		154,373,210	152,866,356

Vlera prej 154.373.210 lekë përbëhet nga :

47.14.238 lekë janë të arkëtueshme nga aktiviteti I shitjes së skrapit dhe koksit (Albbakrit) etj

6.330.605 leke qera asetesh nga subjektet private te pa derdhura per nje periudhe deri ne 3 vjet.

33.620.733 leke jane debitore te krijuar nga vitet 1999 e ne vazhdim .

66.846.509 leke TVSH per rimbursim e trashëguar nga viti 2000 .

15. Inventaret

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

13



ALBKROM sh.a.

Shenime per pasqyrat financiare për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2020

(Te gjitha shumat jane ne LEK, nese nuk shprehet ndryshe)

Zhvlerësimi i inventarit gjëndje në 31 Dhjetor 2020 lidhet me vlerën e artikujve të përcaktuar si njësi të cilat vlerësohen se janë inventar me qarkullim të ngadalshëm dhe se mundësia e përdorimit të tyre është shumë e vogël.

Inventare	Monedha	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
		Vlera ne leke	Vlera ne leke
Produkte të gatshme	Leke	6,356,790	302,040
Mallra magazine	Leke	855,695	933,620
Skrap(nga mjetet e transp)	Leke	2,158,398	2,158,398
Totali		9,370,883	3,394,058

14



REPUBLICA E SHQIPËRIE
MINISTRI I TREGTISË DHE URBANIZIMIT

ALBKROM sh.a.

Shenime per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2020
(Te gjitha shumtat jane ne L.E.K, nese nuk shprehet ndryshe)

AKTIVET AFATGJATA -MATERIALE VITI 2020

	Toke	Galeri	Ndërtesa Industriale	Ndërtesa Civile	Vepra Infrastrukturore	Ndërtesa	Makineri paisje	Mjete transporti	Pajisje Zyre	Pajisje Informatike	Totali
Kosto më 01.01.2019	63,095,451	1,341,856,900	114,023,777	51,316,287	79,543,826	244,883,890	36,622,443	18,929,625	2,026,376	483,191	1,707,897,876
Shtesa kaluar nga koncesioni											
Pakesime (jashte perdorimi)											
Mungese											
Shitje	-										
Blerje											
Kosto më 31.12.2019	63,095,451	1,341,856,900	114,023,777	51,316,287	79,543,826	244,883,890	36,622,443	18,929,625	2,026,376	483,191	1,707,897,876
Amortizimi Akumuluar 31.12.2019	-	1,261,286,005	97,765,462	43,977,774	74,237,526	215,980,763	21,333,386	18,075,257	2,026,376	342,839	1,519,044,624
Pakësime (Nxjerrje Jashtë Perdorimi)											
Pakësime ()											
Amortizimi per vitin 2020										25,263	
Amortizimi Akumuluar 31.12.2020	-	1,261,286,005	97,765,462	43,977,774	74,237,526	215,980,763	21,333,385	18,075,257	2,026,376	368,102	1,519,069,888
Vlera kontabel neto 31.12.2019	63,095,451	80,570,895	16,258,315	7,338,513	5,306,300	28,903,127	16,864,994	854,368	0	140,352	188,853,251
Vlera kontabel neto 31.12.2020	63,095,451	80,570,895	16,258,315	7,338,513	5,306,300	28,903,127	15,289,058	854,368	-	115,089	188,827,989

AKTIVET AFATGJATA JO - MATERIALE VITI 2020

Pershkrimi	Vlera
Koncesione,patenta,licenca,marka tregtare,të drejta dhe aktive të ngjashme	3,953,290,913

Albkrom sh.p.k

Shenime per pasqyrat financiare për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2020
(Te gjitha shumat jane ne LEK, nese nuk shprehet ndryshe)

Detyrimet afatshkurtra

		31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
		Vlera ne leke	Vlera ne leke
Detyrime afatshkurtra	Monedha		
Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore	Leke	2,630,518	480,568
Të pagueshme për detyrimet tatimore	Leke	70,420	16,403
Paga te ish punonjesve me Vendim Gjykate	Leke	242,420	242,420
Të tjera (huara afatshkurter)	Leke	43,000,000	43,000,000
Totali		45,943,358	43,739,391

Të pagueshme për pagat e punonjesve, detyrime tatimore përbëhet sigurimet shoqerore , tatim page, ne vleren 2.630.518 leke, tatim i mbajtur në burim 70.420 leke për muajin nentor-dhjetor 2020 pa paguar. Vlera prej 242.420 leke janë detyrime ndaj punonjësve të krijuara në vitet 2002-2010.

Vlera prej **43.000.000 leke** përbëhet nga një detyrim që shoqëria ka ndaj Shoqërisë Albpetrol sha Patos e cila është marrë në formën e huapërdorjes sipas kontratës Nr. 4306 prot, datë 20.05.2015 e nënshkruar midis palëve dhe huase se marrë në janar 2018 në vlerën 3.000.000 lekë nga Albpetrol Patos Fier me kontrate huaje me Nr. 188/5 prot datë 29.12.2017 .

16. Detyrime Afagjatë

Shoqëria ka detyrime të cilat janë të pa ndryshueshme ndër vite

		31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor19
		Vlera ne leke	Vlera ne leke
Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	Monedha		
Kredi RZB (Tropoje)	Leke	62,024,352	62,024,352
Kredi RZB (ishB. Kursimeve)	Leke	1,120,000	1,120,000
Totali		63,144,352	63,144,352

Detyrimet ndaj institucioneve të kredisë paraqet shumën e huamarrjes më 31.12.2020 të palikuiduar nga shoqëria në vlerën 63.144.352 lekë. Kjo shumë nuk konfirmohet nga institucioni kredidhënës.



ALBKROM sh.a.

Shenime per pasqyrat financiare për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2020

(Te gjitha shumat jane ne LEK, nese nuk shprehet ndryshe)

		31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	Monedha	Vlera ne leke	Vlera ne leke
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	Leke	332,827,513	331,397,035
Te drejta e detyrime te koncesionarit	Leke	2,342,415,718	2,342,415,718
Totali		2,675,243,231	2,673,812,753

17. Të tjera Detyrime Afatgjatë

		31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Te Tjera Afatgjate	Monedha	Vlera ne leke	Vlera ne leke
Të ardhura të shtyra	Leke	112,256,040	106,201,290
Provizione:	Leke	2,364,275	2,364,275
Totali		114,620,315	108,565,565

Të ardhura të shtyra prej 116.201.290 lek rezulton e pa justifikuar që nga koha kur shoqëria "Albkrom"sha përpunonte bilancet e njëjste të saj.

Vlera prej 6 054.750 leke eshte krijuar vlera e sasise se sterile kromit bere hyrje ne inventarin e shoqerise produkt i gatshem miratuar me Urdher te MFE Nr. _____ Date

Provigjoni i krijuar me vlerën 2.364.275 lekë janë vendime gjyqësore gjatë viti 2016 dhe 2017 për detyrime që shoqëria ka ndaj ish-punonjësve të shoqërisë.

18. Kapitali dhe Rezervat

Kapitali Regjistruar

	Nr i Aksioneve	Vlera Nominale e Aksionit	Kapitali aksionar	Vlera e kapitalit të shlyer
Ministria e Financave dhe Ekonomise ,	3.405.413,00	1.000,00	3.405.413.244,00	3.405.413.244,00
<i>Rezerva Rivlerësimi</i>		<i>1.547.029.358 ALL</i>		
<i>Rezerva Ligjore</i>		<i>39.410.111 ALL</i>		
<i>Rezerva të tjera</i>		<i>25.074.303 ALL</i>		
<i>Fitimet e Pashpërndara</i>		<i>-3.607.777.403 ALL</i>		
<i>Rezultati i Ushtrimit 2020</i>		<i>-2.204.413 ALL</i>		



ALBKROM sh.a.

Shenime per pasqyrat financiare për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2020

(Te gjitha shumat jane ne LEK, nese nuk shprehet ndryshe)

Te Ardhura te tjera		31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Te Ardhurat	Monedha	Vlera ne leke	Vlera ne leke
Te ardhura nga shitjet (sterile Kromi)			6.962.810
Te ardhura nga Buxheti, subvencione	Leke	11.560.000	8,690,000
Te ardhura nga qirate	Leke	1.378.917	1,382,407
Te ardhura nga kembimi valutor	Leke		
Te ardhura te ndryshme	Leke	4,000	8000
Te ardhura nga interesat	Leke		72
Totali		12,942.917	17,114,102

19. Shpenzime për Personelin

		31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Shpenzime të personelit	Monedha	Vlera ne leke	Vlera ne leke
Paga dhe shpërblime	Leke	(10,958,728)	(12,232,364)
Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore	Leke	(1,813,711)	(2,042,805)
Totali		(12,942,917)	(14,275,169)

Shpenzimet e punësimit (pagat dhe sigurimet shoqërore & shëndetësore) janë dokumentuar dhe paraqitur në shpenzimet për personelin, gjithashtu edhe detyrimet fiskale të punëmarrësit në lidhje me pagën e përfutur janë dokumentuar dhe paraqitur saktë në Pasqyrat Financiare.

Numri i punonjesve te shoqerise per vitin 2020 ka qene 19 punonjes.

21. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

		31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
	Monedha	Vlera ne leke	Vlera ne leke
Shpenzime per kancelari	Leke	(37,174)	(86,075)
Shpenzime per pjese nderrimi riparime	Leke		
Shpenzime per karburant	Leke	(40,750)	(244,500)
Bl.energj,avull,uje	Leke	(50,393)	(83,568)
Shpenzime evadim kimikatesh	Leke	-	-
Qira zyre	Leke		



ALBKROM sh.a.

Shenime per pasqyrat financiare për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2020

(Te gjitha shumat jane ne LEK, nese nuk shprehet ndryshe)

Sherbime zyra regjist pasurise	Leke		
Mirembajtje dhe riparime	Leke	(6,167)	(15,000)
Sigurime mjete	Leke		
Te tjera (kesh mibkqyres)	Leke	(773,989)	(948,682)
Personel nga jashte ndermarjes(Roje Past.)	Leke	(270,000)	(270,000)
Paga ndermjetes, honorare(eksp bilanci, vlers)	Leke	(763,200)	(465,900)
Transferime, udhetim, dieta	Leke	(108,480)	(512,500)
Shpz.postare e telekom.	Leke	(29,400)	(30,891)
Sherbime bankare	Leke	(17,184)	(42,247)
Te tjera (shlyerje kreditoresh)	Leke		
Gjoha, demshperblime, kamatvonesa sigur.tatim	Leke	(243,891)	(10,204)
Shpenzime te tjera(gjyqesor)	Leke	(9,00)	(40,501)
Shpenzime per interesa humbje kembimi valuator	Leke		(4,234)
Amortizimi I AQT viti 2018	Leke	(25,263)	(32,366)
Totali		(2,374,891)	(2,838,934)

20. Shpenzime amortizimi dhe zhvleresime

Amortizimi	Monedha	31 Dhjetor	31 Dhjetor
		2020	2019
		Vlera ne leke	Vlera ne leke
Amortizimi dhe Zhvleresimet	Leke	(25,263)	(32,366)
Totali		(25,263)	(32,366)

24.Rezultatit Tatimore dhe Fitimi Neto

Rezultati tatimor	Monedha	31 Dhjetor	31 Dhjetor
		2020	2019
		Vlera ne leke	Vlera ne leke
Fitimi para tatimit	Leke	(2,204,413)	(70,814)
Shpenzime te panjohura	Leke	0	0
Fitimi fiscal	Leke	(2,204,413)	(70,814)
Tatim fitimi (15 %)	Leke	0	0
Fitimi Neto		(2,204,413)	(70,814)



ALBKROM sh.a.

Shenime per pasqyrat financiare për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2020

(Te gjitha shumat jane ne LEK, nese nuk shprehet ndryshe)

25 Angazhime dhe detyrime te kushtezuara

Çështje gjyqësore

Me 31.12.2020 shoqeria ka ne proces disa ceshtje gjyqesore ndaj disa debitoreve te cilat jane ne faza te ndryshme ne Apel dhe ne Rekurs.

Detyrime tatimore

Librat e Shoqerise nuk jane kontrolluar nga organet tatimore per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020. Si rrjedhoje detyrimet tatimore nuk mund te konsiderohen perfundimtare.

LIKUIDATORI

Flamur QELI



K/DEGES SE FINANCES

Raimonda DURO

A handwritten signature in blue ink, appearing to be "Raimonda Duro".



20

Emertimi dhe Forma ligjore	ALBKROM SHA (ne likuidim e siper) Tirane
NIPT -i	J61827513H
Adresa e Selise	Biloku "Vasil Shanto"
	TIRANE
Data e krijimit	03.01.1992
Nr. i Regjistrimit Tregetar	2061790013
Veprimtaria Kryesore	Shoqeri ne likuidim

PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit Nr.2 te Permiresuar dhe Ligjit Nr. 9228 Date 29.04.2004 Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare)

Viti 2020

Pasqyra Financiare jane individuale _____
Pasqyra Financiare jane te konsoliduara _____
Pasqyra Financiare jane te shprehura ne _____
Pasqyra Financiare jane te rumbullakosura ne _____

Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare

Nga 01.01.2020

Deri 31.12.2020

Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare

31.03.2021



SH.A."ALBKROM' (ne likuidim e siper)

A K T I V E T	Sheni met	2,020	2,019
Aktivitet Afatshkurtra			
▶ Aktivitet monetare	13	33,459	7,096
1 <i>Banka</i>		33,459	7,096
2 <i>Arka</i>		0	0
▶ Investime			
1 <i>Në tituj pronësie të njësjive ekonomike brenda grupit</i>			
2 <i>Aksionet e veta</i>			
3 <i>Te tjera Financiare</i>			
▶ Të drejta të arkëtueshme	14	154,373,210	152,866,356
1 <i>Nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>		54,211,895	52,483,425
2 <i>Nga njësitë ekonomike brenda grupit</i>			
3 <i>Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>			
4 <i>Të tjera</i>		100,161,315	100,382,931
5 <i>Kapital i nënshkruar i papaguar</i>			
▶ Inventarët	15	9,370,883	3,394,058
1 <i>Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme</i>			
2 <i>Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte</i>			
3 <i>Produkte të gatshme</i>		6,356,790	302,040
4 <i>Mallra magazine</i>		855,695.00	933,619.51
5 <i>Mallra (skrap prej mjeteve)</i>		2,158,398.00	2,158,398.00
▶ Shpenzime të shtyra			
▶ Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara			
TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA		163,777,552	156,267,509
Aktivitet Afatgjata			
▶ Aktive financiare	16	0	0
1 <i>Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit</i>			
2 <i>Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit</i>			
3 <i>Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>			
4 <i>Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>			
5 <i>Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata</i>			
6 <i>Investime financiare afatgjata(Kredi)</i>		0	0
▶ Aktivitet materiale	17	188,827,987	188,853,249
1 <i>Toka dhe ndërtesa galeri</i>		172,569,473	172,569,473
2 <i>Impiante dhe makineri</i>		15,289,057	15,289,057
3 <i>Të tjera Instalime dhe pajisje inventar ekonomik mjete transporti</i>		115,089	140,351
4 <i>Parapagime për aktive materiale dhe në proces</i>		854,368	854,368
▶ Aktivitet biologjike			
▶ Aktive jo materiale:	17	3,953,290,913	3,953,290,913
1 <i>Koncesione,patenta,licenca,marka tregtare,të drejta dhe aktive të</i>		3,953,290,913	3,953,290,913
▶ Aktive tatimore të shtyra			
▶ Kapitali i nënshkruar i papaguar			
TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA		4,142,118,900	4,142,144,162
AKTIVE TOTALE		4,305,896,452	4,298,411,671



Handwritten signature

SH.A."ALBKROM' (ne likuidim e siper)

DETYRIMET DHE KAPITALI		31.12.2020	31.12.2019	
▶ Detyrime afatshkurtra:		45,943,358	43,739,391	
1	Titujt e huamarrjes			
2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë			
3	Arkëtime në avancë për porosi			
4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit			
5	Dëftesa të pagueshme			
6	Të pagueshme ndaj njërive ekonomike brenda grupit			
7	Të pagueshme ndaj njërive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse			
8	Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shën	18	2,630,518	480,568
9	Të pagueshme për detyrimet tatimore	18	70,420	16,403
10	Paga te ish punonjesve	18	242,420	242,420
11	Të tjera (huara afatshkurter)	18	43,000,000	43,000,000
▶ Të pagueshme për shpenzime të konstatuara				
▶ Grande te ardhura te shtyra				
▶ Provizione				
Totali i Detyrimeve afatshkurtera		45,943,358	43,739,391	
▶ Detyrime afatgjata:		2,738,387,583	2,736,957,105	
1	Titujt e huamarrjes			
2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	19	63,144,352	63,144,352
3	Arkëtimet në avancë për porosi			
4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	19	332,827,513	331,397,035
5	Te drejta e detyrime te koncesionarit	19	2,342,415,718	2,342,415,718
6	Të pagueshme ndaj njërive ekonomike brenda grupit			
7	Të pagueshme ndaj njërive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse			
8	Të tjera të pagueshme			
▶ Të pagueshme për shpenzime të konstatuara				
▶ Të ardhura të shtyra		20	112,256,040	106,201,290
▶ Provizione:		20	2,364,275	2,364,275
1	Provizione për pensionet			
2	Provizione të tjera (vendime gjyqate ish punonjes)		2,364,275	2,364,275
▶ Detyrime tatimore të shtyra				
Totali i Detyrimeve afatgjata		2,853,007,898	2,845,522,670	
DETYRIMET TOTALE		2,898,951,256	2,889,262,061	
▶ Kapitali dhe Rezervat				
▶ Kapitali i Nënshkruar		21	3,405,413,240	3,405,413,240
▶ Primi i lidhur me kapitalin				
▶ Rezerva rivlerësimi		21	1,547,029,358	1,547,029,358
▶ Rezerva të tjera		21	64,484,414	64,484,414
1	Rezerva ligjore	21	39,410,111	39,410,111
2	Rezerva statutore			
3	Rezerva të tjera	21	25,074,303	25,074,303
▶ Fitimi i pashpërndarë		21	(3,607,777,403)	(3,607,706,589)
▶ Fitim / Humbja e Vitit		21	(2,204,413)	(70,814)
Totali i Kapitalit			1,406,945,196	1,409,149,610
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT			4,305,896,452	4,298,411,671



	Pershkrimi i Elementeve	nenim	2,020	2,019
▶	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	22	0	0
▶	Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces			
▶	Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar	22	12,942,917	17,043,288
▶	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit (qera asetesh)		1,378,917	1,382,407
	Te ardhura te tjera (Fonde nga buxheti)		11,560,000	8,690,000
▶	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		4,000	6,970,882
	<i>Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</i>			6,962,810
	<i>Të tjera shpenzime</i>		4,000	8,072
▶	Shpenzime të personelit	23	(12,772,439)	(14,275,169)
	<i>Paga dhe shpërblime</i>	23	(10,958,728)	(12,232,364)
	<i>Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veç nga shpenzimet për pensionet)</i>	23	(1,813,711)	(2,042,805)
▶	Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	25		
▶	Shpenzime konsumi dhe amortizimi		(25,263)	(32,366)
▶	Shpenzime të tjera shfrytëzimi	24	(2,349,625)	(2,806,568)
▶	Të ardhura të tjera		0	0
	<i>Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)</i>			
	<i>Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve af (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)</i>			
	<i>Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme (pa veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)</i>			
▶	Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve fin			
▶	aktive afatshkurtra			
▶	Shpenzime financiare		0	0
	<i>Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veç shpenzimet për t'u paguar tek njësitë ekonomike brenda grupit)</i>			
	<i>Shpenzime të tjera financiare</i>			
▶	Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet			
▶	Fitimi/Humbja para tatimit	26	(2,204,410)	(70,814)
▶	Shpenzimi i tatimit mbi fitimin			
	<i>Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin</i>			
	<i>Shpenzimi i tatim fitimit të shtyrë</i>			
	<i>Pjesa e tatim fitimit të pjesëmarrjeve</i>			
▶	Fitimi/Humbja e vitit	26	(2,204,409.88)	(70,813.75)
▶	Fitimi/Humbja për:			
	<i>Pronarët e njësisë ekonomike mëmë</i>			
	<i>Interesat jo-kontrolluese</i>			

Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse

Nr	Pershkrimi i Elementeve		2020	2,019
▶	Fitimi/Humbja e vitit	46	(2,204,410)	(70,814)
	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:	46.1		
	Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari	46.2		
	Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata mate	46.3		
	Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktivet financiare të mb	46.4		
	Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet	46.5		
▶	Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	47	0	0
▶	Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	48	(2,204,410)	(70,814)
▶	Totali i të ardhurave/humbjeve gjithëpërfshirëse për:	49		
	<i>Pronarët e njësisë ekonomike mëmë</i>	49.1		
	<i>Interesat jo-kontrolluese</i>	49.2		

Handwritten signature



SH.A. "ALBKROM" (ne likuidim e siper)

	Kapitali i nënshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva Ligjore	Rezerva Statuore	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali	Interesa Jo-Kontrolues	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	3,405,413,240		1,547,029,358	39,410,111		25,074,303	(3,607,706,589)		1,409,220,423		1,409,220,423
Efekt i ndryshimeve në politikat kontabël									0		0
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2019	3,405,413,240	0	1,547,029,358	39,410,111	0	25,074,303	(3,607,706,589)		1,409,220,423	0	1,409,220,423
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:									0		0
Fitim / Humbja e vitit								(70,814)	(70,814)		(70,814)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:									0		0
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:									0		0
Sistemim veprimi kreditore debitorë nga vitet e kaluara									0		0
Emetimi i kapitalit të nënshkruar									0		0
Dividendë të paguar									0		0
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike									0		0
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2019	3,405,413,240	0	1,547,029,358	39,410,111	0	25,074,303	(3,607,706,589)		1,409,220,423	0	1,409,220,423
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2019	3,405,413,240	0	1,547,029,358	39,410,111	0	25,074,303	(3,607,706,589)		1,409,220,423	0	1,409,220,423
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:									0		0
Fitim / Humbja e vitit								(2,204,413)	(2,204,413)		(2,204,413)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:									0		0
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:									0		0
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:									0		0
Emetimi i kapitalit të nënshkruar									0		0
Dividendë të paguar									0		0
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike									0		0
Pozicioni financiar më 31 12.2020	3,405,413,240	0	1,547,029,358	39,410,111	0	25,074,303	(3,607,706,589)	(2,204,413)	1,407,016,010	0	1,407,016,010

SH.A. "ALBKROM" (ne likuidim e siper)

	2020
► Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	
<i>Fitim / Humbja e vitit</i>	(2,204,410)
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>	
<i>Shpenzimet financiare jomonetare</i>	
<i>Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar</i>	
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>	25,263
<i>Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale</i>	
<i>Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:</i>	
<i>Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>	
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>	
<i>Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera</i>	(1,506,854)
<i>Rënie/(rritje) në inventarë</i>	(5,976,825)
<i>Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme</i>	2,203,967
<i>Rritje/renie llog. Ter tjera A/P</i>	(5,885,879)
<i>Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit</i>	
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(13,344,739)
► Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	
<i>Para neto të përdorura për blerjen e filialeve</i>	
<i>Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve</i>	
<i>Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale</i>	
<i>Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>	
<i>Pagesa për blerjen e investimeve të tjera</i>	
<i>Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera</i>	
<i>Dividentë të arkëtuara</i>	
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	0
► Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	
<i>Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar</i>	
<i>Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral</i>	
<i>Hua të arkëtuara</i>	
<i>Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë</i>	
<i>Riblerje e aksioneve të veta</i>	
<i>Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral</i>	
<i>Pagesa e huave</i>	
<i>Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare</i>	
<i>Interes i paguar</i>	
<i>Dividendë të paguar</i>	
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	0
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve	(13,344,739)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	7,096
<i>Efekti i llogaritjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	33,459



 REPUBLIKA E ALBANIË
 MINISTERIA E FINANÇARË
 TITULLI I SHËRBYESIT

AKTIVET AFATGJATA -MATERIALE VITI 2020

	Toka	Galeri	Ndërtesa Industriale	Ndërtesa Civile	Vepra Infrastruktur ore	Ndërtesa	Makineri paisje	Mjete transporti	Pajisje Zyre	Pajisje Informatike	Totali
Kosto më 31.12.2019	63,095,451	1,341,856,900	114,023,777	51,316,287	79,543,826	244,883,890	36,622,443	18,929,625	2,026,376	483,191	1,707,897,876
Shtesa kaluar nga koncenioni											
Pakesime (mungesa)											
Shitje	-										
Blerje											
Kosto më 31.12.2020	63,095,451	1,341,856,900	114,023,777	51,316,287	79,543,826	244,883,890	36,622,443	18,929,625	2,026,376	483,191	1,707,897,876
Amortizimi Akumuluar 31.12.2019	-	1,261,286,005	97,765,462	43,977,774	74,237,526	215,980,763	21,333,386	18,075,257	2,026,376	342,839	1,519,044,626
Pakesime (Nxjerrje Jashtë Përdorimi)											
Pakesime ()											
Amortizimi per vitin 2020										25,263	25,263
Amortizimi Akumuluar 31.12.2020	-	1,261,286,005	97,765,462	43,977,774	74,237,526	215,980,763	21,333,386	18,075,257	2,026,376	368,102	1,519,069,889
Vlera kontabel neto 31.12.2019	63,095,451	80,570,895	16,258,315	7,338,513	5,306,300	28,903,127	15,289,057	854,368	-	140,352	188,853,250
Vlera kontabel neto 31.12.2020	63,095,451	80,570,895	16,258,315	7,338,513	5,306,300	28,903,127	15,289,057	854,368	-	115,089	188,827,987

AKTIVET AFATGJATA JO - MATERIALE VITI 2019

Pershkrimi	Vlera
Koncenioni	3,953,290,913

ok



PER NOTES
RATONANT
DURD

Nr. 121 Prot.
15.11.02.2021.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

Nr. 2753 Prot.

Tiranë, më 10.11.2021

Lënda: Mbi caktimin e Audituesëve ligjor për certifikim bilanci.

SH.A "ALBKROM"

TIRANË

Mbështetur në Ligjin Nr. 9901 datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Neni 135 "Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë", për të kontrolluar dhe certifikuar llogaritë vjetore, caktohen si Auditues Ligjor;

1. Albanian Consultancy shpk
2. TPA Albania shpk

Struktura përgjegjëse në MFE para fillimit të punës, harton me Audituesit një projekt-marrëveshje për punën që do të kryhet, me përshkrimin e rubrikave të verifikimeve, kontrolleve, raportimeve etj, për përmbushjen e misionit, orët e punës të parashikuara si dhe honorarin.

Përveç raportit standard të auditimit, ekspertët të dorëzojnë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë relacion shpjegues për të gjithë zërat e bilancit, si dhe sugjerimet e tyre për shoqëritë në vështirësi financiare.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

